



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Drejtoria e Integrimit dhe Projekteve

BURSA UNIVERSITARE DHE PASUNIVERSITARE NË KINË,
VITI AKADEMIK 2014-2015

Në zbatim të Marrëveshjes së bashkëpunimit dypalësh në fushën e arsimit, Qeveria e Republikës Popullore të Kinës ofron 2 (dy) bursa për studime universitare ose pasuniversitare në Universitetet Publike të Kinës, për vitin akademik 2014-2015.

Aplikantët duhet të paraqesin pranë Drejtorisë së Integrimit dhe Projekteve në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dokumentet e mëposhtme:

Për studime universitare:

1. Kërkesën me shkrim, ku të specifikohet fusha e studimit;
2. Vërtetimin e notave për tri vitet e shkollës së mesme. Ky vërtetim duhet të jetë i firmosur nga Drejtoria ose Zyra Arsimore e rrethit përkatës;
3. Letrën e interesit ose një plan studimi për programin e studimit;
4. Një CV që përmban informacion për ciklet e shkollimit dhe adresat e shkollave ku aplikanti ka studiuar;
5. Raportin mjekësor për aftësi studimi;
6. Fotokopjen e faqes së të dhënave të pasaportës.
7. 4 fotografi

Për studime pasuniversitare:

1. Kërkesën me shkrim, ku të specifikohet fusha e studimit;
2. Kopjen e noterizuar të diplomës që vërteton mbarimin e nivelit të parë të studimeve universitare ose të nivelit të dytë të studimeve pasuniversitare ;
3. Listën e notave, fotokopjen e noterizuar;
4. Letrën e interesit ose një plan studimi për programin e studimit;
5. Një CV që përmban informacion për ciklet e shkollimit dhe adresat e shkollave ku aplikanti ka studiuar.
6. Raportin mjekësor për aftësi studimi
7. Fotokopjen e faqes së të dhënave të pasaportës.
8. 4 fotografi

Afati i fundit për dorëzimin e dokumenteve në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit është data **4 prill 2014.**

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE